



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 6-18 MUAJ MUAJI NËNTOR



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

 Fëmijët e Tiranës

<http://femijetetiranes.al/>

 femijet_e_tiranes

Programi i Edukimit për Fëmijët 18-24 Muaj
Psiko-Social

© Sektori i Zhvillimit dhe Kujdesit

Kuriozitete për Muajin Nëntor



Çfarë mund të dimë për Nëntorin?

- * Muaji Nëntor është **muaji i tretë** i vjeshtës.
- * Në Nëntor, **ditët bëhen më të shkurtra** dhe më të ftohta se ditët në Tetor.
- * Frutat si **mandarinat, portokallet, shegët, hurmat**, ne nisim t'i shijojmë në Nëntor.
- * Nëntori është **muaji i Të Drejtave** të fëmijëve.
- * Nëntori është **muaji i festave kombëtare** të vendit tonë: Dita e Pavarësisë dhe Dita e Çlirimit.

Muaji Nëntor

Tema: Njohja e Vetes dhe Të Drejtat e Fëmijëve

Grupi latant: 6-18 muaj



- * **Java I:** Njohja e vetes
- * **Java II:** Veshjet për fëmijët
- * **Java III:** Të drejtat e fëmijëve
- * **Java IV:** Festat dhe festimi i tyre




Tema mujore: Njohja e Vetes dhe Të drejtat e Fëmijëve



Tema Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Njohja e vetes	Njohja me elementët e vetes	Java I
Lodrat dhe veshjet e fëmijëve	Njohja me veshjet për fëmijë	Java II
Të drejtat e fëmijëve	Njohja me të drejtat e fëmijëve	Java III
Festat dhe festimi i tyre	Festojmë festat së bashku	Java IV







- * Stafi edukator duhet të marrë pjesë në çdo aktivitet dhe temë ditore bashkë me fëmijët.
- * Stafi i praktikon aktivitetet në bazë të zhvillimit dhe interesave të fëmijëve.
- * Stafi duhet të informojë prindërit mbi temën mujore dhe javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.





Tema e Muajit: Njohja e Vetes dhe Të drejtat e Fëmijëve

Tema e Javës: Njohja e Vetes






Java I	Tema	Aktivitetet	Mjetet
E Hënë	Fytyra ime 	<p>Biseda: Edukatorja iu tregon me gisht fëmijëve shqisat te fytyra e kukullës/bebit lodër dhe te fytyra e vet. Edukatorja emërtton pjesët e fytyrës: SY-RI, GO-JA, VE-SHI, HU-NDA... Etj.</p> <p>Loja me pasqyrë: E vendosim fëmijën përballë pasqyrës. Me gisht tregojmë pjesët e fytyrës së tij/saj dhe i emërtojmë ato. E nxisim fëmijën të tregojë me gisht shqisat e tij/saj.</p> <p>Ilustrim me figurat e librave (pjesët e fytyrës/shqisat).</p> <p>Vjersha: “Shqisat”</p>	<p>Kukulla, pasqyrë, libra me figura</p> 

<p>E Martë</p>	<p>Trupi im</p> 	<p>Biseda: Edukatorja tregon me gisht dhe emërton para fëmijëve pjesët e trupit (te vetja/ te kukulla, pastaj me radhë te fëmijë të ndryshëm). Edukatorja i masazhon lehtë fëmijët dhe emërton pjesët e trupit.</p> <p>Ilustrim me foto: Përdorim fotot e fëmijëve të grupit për të treguar me gisht dhe emërtuar pjesët e trupit.</p> <p>Këngë lëvizore: “Nëse ti je i lumtur...”/ “Duart nga e majta...”</p>	<p>Kukulla, arusha, foto</p>  
<p>E Mërkurë</p>	<p>Në pasqyrë jam Unë!</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u përsërit fëmijëve pjesët e fytyrës dhe pjesët e trupit, duke i treguar me gisht dhe emërtuar ato.</p> <p>Loja e pasqyrës: I vendosim fëmijët para pasqyrës dhe i nxisim të tregojnë pjesët e fytyrës dhe trupit.</p> <p>Loja: “Gjurma e dorës/ këmbës” Paraprakisht, edukatorja përgatit brumë dhe e hap në një sipërfaqe të sheshtë, pastaj i nxit fëmijët të vendosin duart dhe këmbët për të lënë gjurmë në të. Më pas, gjurmët mund t'i ngjyrosim me fëmijët.</p>	<p>Pasqyrë, miell/ brumë, penela</p>  

<p>E Enjte</p>	<p>Emri im</p> 	<p>Biseda: Edukatorja ulet me fëmijët dhe thërret emrat e tyre një e nga një. Pastaj u hap lodrat në tapet dhe pasi ata zgjedhin lodrën e tyre, thërret emrin e fëmijës duke e shoqëruar me veprimin: “Sara mori topin”, “Amari po luan me rrake”, etj. Edhe gjatë ditës, edukatorja i thërret herë pas here fëmijët në emër duke përshkruar veprimet dhe preferencat e tyre: “Mia po ha supë; Diarit i pëlqen molla”, etj.</p> <p>Lojë me top. Edukatorja ia jep/ hedh topin fëmijës dhe e thërret në emër duke brohoritur.</p> <p>Përrallë e lirë. Zgjedhim një përrallë dhe ua lexojmë fëmijëve. Emërtojmë figurat dhe emrat e personazheve.</p> <p>Këngë lëvizore: “Nëse ti je i lumtur...”/ “Duart nga e majta...”</p>	<p>Top, libër me përralla</p> 
<p>E Premte</p>	<p>Lojëra me shqisat</p> 	<p>Lojë sensore: Edukatorja improvizon tinguj të ndryshëm që fëmijët t'i dëgjojnë (përplas duart, këmbët, lodrat, troket në derë, bën tinguj shshsh, sssss, etj.). Emërtohen cilësitë e tingujve “i fortë, i butë; i lartë, i ulët”. Përfshini edhe shqisat e tjera: <i>prekja</i> (u japim materiale të ndryshme për t'i prekur), <i>nuhatja</i> (i mbajmë erë lules, ushqimit, etj.), <i>shikimi</i> (tregimi i figurave në libër).</p> <p>Shishet akustike: Mbushim disa shishe plastike me materiale si oriz, rërë, ujë, makarona, kopsa, etj. dhe luajmë me tingujt e tyre.</p> <p>Përsëritje e vjershave dhe këngëve të javës.</p>	<p>Materiale të ndryshme në grup, shishe plastike</p> 



<p>E Martë</p>	<p>Rrobat e mia</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja emërton veshjet e fëmijëve (bluza, trikoja, fustani, tutat, getat, shalli, kapelja, etj). Emërton ngjyrat e tyre dhe materialet (e butë, e trashë).</p> <p>Loja: Veshja-zhveshja e arushit/kukullës</p> <p>Vjersha: “Jam një vajzë simpatike” / “Xhepi im i vogël”</p> <p>Përrallë: “Hirushja” (ose një përrallë tjetër nga librat që keni në grup).</p>	<p>Veshjet e fëmijëve, kukulla/arushi, libra</p> 
<p>E Mërkurë</p>	<p>Rrobat e kukullës</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u jep fëmijëve kukulla dhe arusha dhe emërton veshjet e tyre, duke i treguar me gisht dhe duke i shqiptuar saktë.</p> <p>Loja: “Kukulla/arushi që vishet” (edukatorja vesh arushin/kukullën duke përdorur edhe veshje të fëmijëve)</p> <p>Vjersha: “Jam një vajzë simpatike” / “Xhepi im i vogël”</p>	<p>Arusha, kukulla</p> 





<p>E Enjte</p>	<p>Aktivite sensorike</p> 	<p>Loja 1: Ngjisim topat me ngjyra</p> <p>Eduktorja i ndihmon fëmijët të ngjisin topa me ngjyra në një shirit ngjitës të ngjitur në dysheme ose në mur. Emërtojmë ngjyrat.</p> <p>Loja 2: Lojë me pipa</p> <p>Mund të përdorim bikerina vezësh, tek të cilat hapim vrima në mesin e tyre pak më të gjera sesa diametri i pipave. I ndihmojmë fëmijët të fusin pipat te vrimat.</p> <p>Kënga: “Lodrat shumë i dua”</p>	<p>Topa, pipa, shishe/bikerina</p> 
<p>E Premte</p>	<p>Dita e Edukatores</p> 	<p><i>Edukatoret mendojnë vetë për aktivitetin që do të organizojnë sot.</i></p> <hr/> <hr/> <hr/>	

Tema e Muajit: Njohja e Vetes dhe Të drejtat e Fëmijëve

Tema e Javës: Të Drejtat e Fëmijëve



Java III	Tema	Aktivitetet	Mjetet
<p>E Hënë</p>	<p>Të drejtat e mia</p> 	<p>Biseda: Edukatorja iu flet fëmijëve dhe iu tregon se të gjithë fëmijët në botë kanë të drejta: “Çdo fëmijë ka një emër, një familje, ka të drejtë të luajë, të mbrohet etj.”</p> <p>Vjersha: “Të drejtat e fëmijëve”</p> <p>Aktivitet: “Rrethi sensor” Nga e hëna në të premte, do të mblidhni materiale të riciklueshme, si fjongo, pëlhura, fije turre, pellush, shall, etj. për të krijuar një rreth gjimnastike (foto). Kështu do të krijojmë një lodër të re në grup që fëmijët mund ta prekin dhe të luajnë.</p> <p><i>(U kërkohet prindërve të sjellin foto familjare për aktivitetin të enjten)</i></p>	<p>Lodra të ndryshme në grup</p> 



<p>E Martë</p>	<p>Kam të drejtë të kem një emër</p> 	<p>Biseda: Edukatorja u thotë fëmijëve që të gjithë kemi një emër. Gjatë ditës, herë pas here, i thërret fëmijët në emër duke treguar me gisht dhe duke përshkruar veprimin që po kryen fëmija: “Ester po luan me kuba; Abi po ecën këmbadorazi, etj.”</p> <p>Vjersha: “Të drejtat e fëmijëve”</p> <p>Lojë: “Loja e telefonit” Edukatorja bën sikur flet në telefon me fëmijët, duke thirrur emrat p.sh: Alo, Dea! Alo, Drini!</p> <p>Kënga: “Hapa dollapa” (mund të përdorim emra të fëmijëve të grupit për ta modifikuar sipas dëshirës këngën)</p>	<p>Telefona lodër, lodra dhe mjete të ndryshme në grup</p> 
<p>E Mërkurë</p>	<p>Kam të drejtë të kem një familje</p> 	<p>Biseda: Përmes fotove, edukatorja u tregon fëmijëve anëtarët e familjes dhe i emërton ata: mami, babi, motra, vëllai, nëna, gjyshi; duke i identifikuar me gisht dhe duke i nxitur edhe fëmijët të tregojnë me gisht.</p> <p>Vjersha: “Familja”</p> <p>Kënga: “Familja e gishtave”</p> <p>Përralla: “Mama dhia dhe kecat”</p>	<p>Libër me përralla, foto familjare</p> 


<p>E Enjte</p>	<p>Kam të drejtë të luaj</p> 	<p>Biseda: Edukatorja u hap lodrat fëmijëve dhe u flet për to. Emërton lodrat dhe tregon se çdo fëmijë ka shumë dëshirë të luajë; se çdo fëmijë mund të ketë një lodër të preferuar, etj.</p> <p>Lojë: “Gjej lodrën” Edukatorja ia fsheh lodrën fëmijës dhe e nxit që ta gjejë atë.</p> <p>Vjersha: “Kam një top”</p>	<p>Lodra të ndryshme në grup</p> 
<p>E Premte</p>	<p>Pema e Grupit</p> 	<p>Përsëritje e këngëve dhe vjershave të javës.</p> <p>Aktivitet 1: Me fotot familjare të sjella nga prindërit, edukatorët krijojnë <i>Pemën e Grupit</i> (aplikacion ose punim dore; foto majtas).</p> <p>Aktivitet 2: Krijimi i rrethit sensor (foto djathtas). Materialet e mbledhura gjatë javës i mbështjellim te një rreth gjimnastikor dhe i vendosim fëmijët pranë tyre që t'i prekin materialet.</p>	<p>Foto, materiale të ndryshme të mbledhura gjatë javës</p> 




Tema e Muajit: Njohja e Vetes dhe Të drejtat e Fëmijëve

Tema e Javës: Festat dhe festimi i tyre



Java IV	Tema	Aktivitetet	Mjetet
E Hënë	Festat 	Biseda: Edukatorja i flet fëmijëve për festat, si: ditëlindja, 1 Qershori, Viti i Ri, etj. Përdorim foto të ditëlindjeve të fëmijëve. Këngë: “Bufi bëri dasëm” Lojë: “Futja e pipave në shishe”	Pipa, shishe 

<p>E Martë</p>	<p>Ditëlindja</p> 	<p>Biseda: Edukatorja iu tregon fëmijëve si festohet ditëlindja: veshja, kapelet festive, tullumbacet (mund të përdorim elementë të tillë konkretë).</p> <p>Këngë: “Kënga e ditëlindjes” (Shumë urime për ty!)</p> <p>Punë dore: “Kapelja” (Edukatorja krijon një model kapeleje festive për të demonstruar elementin e festës).</p> <p>Lojëra me tullumbace.</p>	<p>Tullumbace, letra me ngjyra</p> 
<p>E Mërkurë</p>	<p>Festat e Nëntorit</p> 	<p>Biseda: Edukatorja përdor flamurin e grupit për t’u treguar fëmijëve flamurin shqiptar dhe ngjyrat e tij.</p> <p>Punim me ngjitje: “Flamuri” Edukatorja përgatit disa forma katrore me ngjyrë të kuqe (shablone kartoni) dhe i ndihmon fëmijët t’i ngjisin te letra për të krijuar flamurin.</p> <p>Vjersha: “Flamuri”</p> <p>Këngë festive për flamurin.</p>	<p>Letra me ngjyra të kuqe/të zezë, ngjitës</p> 
<p>E Enjte</p>	<p>Zbukurimi i</p>	<p>Me punimet e djeshme dhe tullumbace me</p>	<p>Flamuj prej letre,</p>

	<p>çerdhes për festa</p> 	<p>ngjyra të ndryshme, edukatorët zbulojnë dhomën dhe u tregojnë fëmijëve elementet festive (ngjyrat, numërojmë).</p> <p>Vjersha: “Flamuri”</p> <p>Lojë me tullumbace me ujë.</p>	<p>tullumbace, shirita zbulues</p> 
<p>E Premte</p>	<p>Festimi i Festave të Nëntorit</p> 	<p>Ekspozitë: “Festat” ku ekspozojmë punimet e javës.</p> <p>Këngë festive.</p> <p>Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit që të sjellin elementë festivë në grup.</p>	<p>Punimet e javës, veshje kuq e zi, flamuj</p> 